

Raporti Vjetor 2024



Dhjetor, 2024



www.dplus.org

Zbuloni më shumë rreth publikimeve tona më të fundit, lajmeve dhe infografikave online.


 @democracyplus  @democracy-plus

 @democracy_plus  @Democracy Plus

Rruga Bajram Kelmendi, Nr.92,
Kati IV, Prishtinë, 10000 Kosovë

+383 (0) 38 749 288

info@dplus.org



Raporti Vjetor 2024



Për Demokraci Plus

05

Ndikimi i D+ në Riciklim
dhe Mbrojtjen e Mjedisit

07

Kontributi në
politika publike

14

Monitorimi i
prokurimit publik

22

Përpjekjet për parandalimin
e përhapjes së lajmeve të
reme

28

Raportimet dhe ndreqjet
në platformën
ndreqe.com

30

Aktivite të tjera

30

Partnerët
dhe donatorët

36

Rreth Demokraci Plus

Ne jemi organizatë e pavarur dhe jofitimprurëse e themeluar në vitin 2016 me përkushtimin për të ndërtuar një shoqëri demokratike në Kosovë. Misioni ynë përqendrohet në rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset politike, promovimin e llogaridhënies dhe ndikimin në procesin e vendimmarrjes në të gjitha nivelet e qeverisjes. Ne përdorim teknologjinë e informacionit për të avancuar këto përpjekje, duke mbështetur përdorimin e mjeteve digjitale për të demokratizuar dhe modernizuar shoqërinë tonë.

Puna jonë kontribuon në krijimin e praktikave të mira të qeverisjes në institucionet publike, si në nivel qendror ashtu edhe lokal, duke forcuar sundimin e ligjit, zhvilluar partitë politike dhe mbështetur procese zgjedhore të lira dhe të ndershme. Përmes hulumtimeve, dialogut publik dhe edukimit, iniciativat tona synojnë të zvogëlojnë hendekun midis vendimmarrësve dhe qytetarëve. Mbi të gjitha, ne mbështesim vlerat dhe praktikat demokratike, duke fuqizuar zërat e qytetarëve të Kosovës dhe duke promovuar një shoqëri më gjithëpërfshirëse dhe pjesëmarrëse.

Gjatë vitit 2024, D+ ka vazhduar të punojë në ndërtimin e një kulture demokratike përmes aktiviteteve të shumta të cilat kanë pasur synim ndikimin në vendimmarrje, forcimin e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike, rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në politikbërje si dhe përmirësimin e zhvillimit të procedurave të prokurimit publik.

Ky raport paraqet një përmbledhje të aktiviteteve të kryera gjatë vitit 2024 nga D+ dhe ndikimin që ato kanë pasur në përmbushjen e misionit tonë.

Vizioni

Qeverisje dhe shoqëri ku kultura dhe vlerat demokratike janë normë.

Misioni

D+ angazhohet për zhvillimin e një shoqërie demokratike, përmes ndikimit në vendimmarrje dhe fuqizimit të pjesëmarrjes qytetare në hartimin dhe zbatimin e politikave publike.

Programet

Qeverisje e Mirë

Sundimi i Ligjit

Partitë Politike dhe Zgjedhjet

1. Ndikimi i D+ në Riciklim dhe Mbrojtjen e Mjedisit

1.1 Fuqizimi i Heronjve Lokal në Riciklim

Si pjesë e Aktivitetit të USAID Riciklimi ka Rëndësi – Graçanicë, mbledhësit jo-formal të materialeve të riciklueshme nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian morën pjesë në trajnim praktik mbi sigurinë dhe praktikat e qëndrueshme të riciklimit. Trajnimi u fokusua në dy tema: trajtimin e materialeve të rrezikshme dhe bazat e nisjes së ndërmarrjeve sociale në fushën e riciklimit. Përmes demonstrimeve praktike, pjesëmarrësit eksploruan se si riciklimi mund të krijojë vlera ekonomike dhe sociale për komunitetet e marginalizuara – duke ndërtuar aftësi për siguri në punë, jetesë më të mirë dhe mjedis më të pastër.

Pjesëmarrësit eksploruan se si riciklimi mund të krijojë vlera ekonomike dhe sociale për komunitetet e marginalizuara.





1.2 Një rrugë e re drejt së ardhmes për komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian në Graçanicë

Berjan Çeliç, dikur mbledhës jo-formal i materialeve të riciklueshme, tani drejton biznesin e tij të riciklimit me mbështetjen e Aktivitetit të USAID Riciklimi ka Rëndësi – Graçanicë. Me prejardhje nga fshati Preocë i Graçanicës, ai fillimisht nisi punën në riciklim më shumë se dy dekada më parë me asgjë më shumë se një karrocë për grumbullimin e bakrit, aluminit, zinkut, çelikut dhe metaleve të tjera nga deponitë e hapura. USAID mbështeti Berjanin me makineri për mbledhjen dhe shtypjen e materialeve të riciklueshme dhe transportimin e tyre në qendrat e riciklimit. Ai gjithashtu mori ndihmë për ta regjistruar biznesin e tij. E gjithë kjo e ka rritur në mënyrë të konsiderueshme sasinë e metaleve dhe plastikës që e përpunon çdo muaj, duke çuar në të ardhura shtesë për të mbajtur familjen e tij. Përmes Aktivitetit të USAID Riciklimi ka Rëndësi – Graçanicë,

Berjani bashkë me dy biznese të tjera të regjistruara, si dhe mbledhësit jo-formal të materialeve të riciklueshme, po punojnë për t'a përmirësuar jetën e tyre duke i kushtuar kohë dhe përkushtim mbrojtjes së mjedisit.

Kjo mbështetje e ka rritur në mënyrë të konsiderueshme sasinë e metaleve dhe plastikës që e përpunon çdo muaj, duke çuar në të ardhura shtesë për të mbajtur familjen e tij.

1.3. Bashkëpunimi në Veprim

Ndërtimi i lidhjeve ndërmjet institucioneve publike dhe komuniteteve të margjinalizuara kontribuon në ndryshime gjithëpërfshirëse dhe rezultate pozitive. Përmes një qasjeje dinamike dhe gjithëpërfshirëse, Aktiviteti i USAID Riciklimi ka Rëndësi – Graçanicë gjatë vitit 2024 organizoi një seri takimesh mes anëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian dhe zyrtarëve komunal për të kërkuar zgjidhje bashkëpunuese për avansimin e integritimit socio-ekonomik. Ndër këto takime, një diskutim i rëndësishëm u zhvillua në mes të grave të këtyre komuniteteve dhe Kryetares së Komunës së Graçanicës, Znj. Ljiljana Subariç. Diskutimet u përqëndruan në çështje si punësimi, arsimi, infrastruktura publike, strehimi, mjedisi dhe sfidat ekonomike. Kryetarja theksoi përkushtimin e komunës për të përmirësuar kushtet e jetesës për të gjithë anëtarët e këtyre komuniteteve, ndërsa përfaqësuesit komunal treguan gatishmëri për të adresuar këto sfida me zgjidhje të përbashkëta.

Aktiviteti ishte i përkushtuar të promovojë kohezionin socio-ekonomik dhe vendimmarrjen gjithëpërfshirëse duke siguruar që zëri dhe nevojat e komuniteteve të dëgjohej, ndërsa inkurajonte komunikimin e vazhdueshëm dhe ndërtimin e kapaciteteve të këtyre komuniteteve.



1.4 Vizita nga përfaqësues të Misionit të USAID

Gjatë këtij viti D+ ka pasur vizita nga përfaqësues të lartë të Misionit të USAID. Ndër këto takime është vizita e Ndihmës Administratores Erin Elizabeth McKee e cila u takua me përfaqësues të komuniteteve rom, ashkali, dhe egjiptian. Gjatë vizitës, Ndihmës Administratorja pa se si mbledhësit jo-formal të materialeve të riciklueshme në Graçanicë po ndihmojnë në mbrojtjen e mjedisit dhe po rrisin të ardhurat e tyre përmes modeleve të qëndrueshme të riciklimit. Po ashtu, në kuadër të Aktivitetit të USAID Riciklimi ka Rëndësi – Graçanicë, Drejtoresha e Misionit të USAID znj. Eileen Devitt ka takuar disa prej përfituesëve të cilët çdo muaj riciklojnë 27 ton mbeturina. Tre nga këta përfitues së fundi kanë regjistruar biznese dhe janë duke kontribuar në kohezionin socio-ekonomik të komuniteteve të tyre përmes riciklimit.



1.5 Promovimi i riciklimit në Graçanicë

Aktiviteti i USAID Riciklimi ka Rëndësi – Graçanicë filloi shpërndarjen e shportave të riciklimit në 250 shtëpi dhe 150 biznese në fshatin Graçanicë. Këto shporta, të destinuar për letër, metal dhe plastikë, shënojnë zgjerimin e programit pilot të suksesshëm nga Llaplasella në lagjen e dytë të riciklimit. Gjithashtu, Aktiviteti organizoi fushatën “derë më derë,” duke informuar çdo qytetar për përfitimet dhe rëndësinë e riciklimit për një mjedis të pastër dhe të qëndrueshëm.

Aktiviteti i USAID Riciklimi ka Rëndësi – Graçanicë filloi shpërndarjen e shportave të riciklimit në 250 shtëpi dhe 150 biznese në fshatin Graçanicë.



Si pjesë e fushatës edukuese, Aktiviteti ndërgjegjësori mbi 400 nxënës të shkollave të mesme për rëndësinë e riciklimit. Eko-këndet në shkolla janë pajisur me shporta për letër, plastikë dhe metal, dhe po nxisin përgjegjësinë mjedisore tek nxënësit. Përveç kësaj, Aktiviteti ka promovuar riciklimin edhe tek nxënësit e shkollave fillore, duke krijuar një bazë të qëndrueshme për një qasje më të përgjegjshme ndaj mjedisit, nga e cila do të përfitojnë të gjitha komunitetet.

1.6 Dëgjimi i parë buxhetor në Lagjen Rome

Puna e palodhur dhe kreativiteti i mbledhësve jo-formal të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian ndihmon Graçanicën të ricikloj 27 tonë mbeturina çdo muaj. Ata janë të vetëdijshëm për shërbimet që u nevojiten për të vazhduar këto përpjekje dhe shohin mundësi për të përmirësuar lagjet e tyre çdo ditë. Me mbështetjen e Aktivitetit të USAID Riciklimi ka Rëndësi – Graçanicë, Komuna e Graçanicës organizoi për herë të parë një dëgjim buxhetor në lagjen Rome për komunitetet e marginalizuara. Qytetarët e kësaj lagje patën mundësi të avokojnë për investime në parqe lojërash, shporta për mbeturina, mbjellje të pemëve, asfaltim të rrugëve dhe ndriçim publik. Takime si këto ndërtojnë besim, kontribuojnë në qeverisje më të përgjegjshme dhe ndihmojnë banorët të kenë qasje në burime për të vazhduar përmirësimin e lagjeve të tyre.



Qytetarët e kësaj lagje patën mundësi të avokojnë për investime në parqe lojërash, shporta për mbeturina, mbjellje të pemëve, asfaltim të rrugëve dhe ndriçim publik.





1.7 Formalizimi i bizneseve të riciklimit

Me mbështetjen e Aktivitetit të USAID Riciklimi ka Rëndësi – Graçanicë, tri familje të komunitetit rom në Graçanicë, të cilat sigurojnë të ardhurat përmes mbledhjes jo-formale të materialeve të riciklueshme, kanë regjistruar biznese formale. Shaqir Tairoviç, Ismet Selimoviç dhe Berjan Çeliç tani drejtojnë biznese të regjistruara duke kontribuar në ekonominë qarkore dhe ruajtjen e mjedisit. Ky progres është arritur përmes trajnimeve, mbështetjes në menaxhimin e biznesit, mbështetjes për procedurat e regjistrimit dhe shërbimeve për planifikim financiar. Këto biznese të reja jo vetëm që po mbështesin jetesën e tyre, por gjithashtu po vendosin themelet për një Graçanicë më të gjelbër përmes praktikave të qëndrueshme mjedisore në mbledhjen e materialeve të riciklueshme.



1.8 Qytetarët dhe komunitetet punojnë së bashku për suksesin e riciklimit

Qytetarët e Graçanicës janë mbledhur për të siguruar që përpjekjet e reja për riciklim në komunën e tyre janë të suksesshme. Aktiviteti i USAID Riciklimi ka Rëndësi – Graçanicë është duke mbështetur mbledhësit jo-formal të materialeve të riciklueshme nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, për të punuar me fqinjët e tyre dhe udhëheqësit komunal për të zgjeruar sistemet lokale të riciklimit. Kjo nismë po ofron mundësi për të fituar të ardhura, ndërsa në të njëjtën kohë është duke mbështetur një të ardhme më të gjelbër dhe më të pastër. Për më tepër, përmes organizimit të takimeve të rregullta publike dhe nxitjes së një dialogu të vazhdueshëm në mes të qytetarëve dhe përfaqësuesve komunal, Aktiviteti po frymëzon banorët që të bashkohen në përpjekjen për një të ardhme më të gjelbër.



2. Kontributi në politika publike

2.1 Mbështetja e Kuvendit të Kosovës në monitorimin e zbatimit të ligjeve

Gjatë vitit 2024, D+ ka mbështetur me ekspertizë grupet punuese të dy komisioneve parlamentare të Kuvendit të Republikës së Kosovës:

I. Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti në hartimin e dy raporteve të monitorimit të zbatimit të ligjeve;

- Ligjin nr. 08/L-021 për Tregti me Jashtë;
- Ligjin nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.

II. Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit në hartimin e raportit të monitorimit të zbatimit të;

- Ligjit nr. 04/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.



2.2 Rekomandime në draft-politika publike në nivel qendror dhe lokal

D+ ka ofruar gjithsej 241 komente për 10 draft-politika publike në nivel lokal dhe qendror, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e jetës së qytetarëve, me fokus të grupeve të margjinalizuara në Kosovë. Komentet janë të ndara si në vijim:

- 149 komente janë dhënë për 6 draft-politika lokale.
- 92 komente janë dhënë për 4 draft-politika në nivel qendror.

Këto rekomandime janë vendosur në platformën e konsultimeve publike dhe gjithashtu janë dërguar në formë elektronike tek zyrtarët përgjegjës në komunat dhe ministritë përkatëse.

D+ ndjek në mënyrë të vazhdueshme procesin e konsultimeve publike, për të monitoruar nëse komentet dhe sygjerimet e ofruara janë marrë në konsideratë nga institucionet përkatëse. Deri në momentin e hartimit të këtij raporti, rezultatet e komenteve të pranuar janë si më poshtë:

➤ Komunat: 84 komente janë pranuar nga komunat dhe janë përfshirë në politikat përkatëse.

➤ Ministritë: Ministritë ende nuk i kanë publikuar raportet përfundimtare që pasqyrojnë rezultatet e procesit të konsultimit publik.

Përmes kësaj qasjeje, D+ synon të rrisë transparencën dhe llogaridhënien në proceset e hartimit të politikave, duke siguruar që zërat e qytetarëve të përfshihen në vendimmarrje.

Përveç kësaj, D+ ka monitoruar prokurimin publik si në nivel qendror ashtu edhe lokal, duke u fokusuar në shtatë (7) institucione publike. Në total, janë analizuar 20 tenderë nga këto institucione, duke rezultuar në dy raporte me gjetje dhe rekomandime.

Përveç kësaj, D+ ka hartuar gjithashtu tri analiza të politikave me rekomandime për përmirësimin e qeverisjes dhe prokurimit publik. Për më tepër, D+ ka kontribuar në mënyrë aktive në diskursin publik mbi qeverisjen dhe transparencën duke: realizuar 83 paraqitje në media mbi çështjet e prokurimit publik dhe qeverisjes, publikuar tri (3) infografika që theksojnë gjetjet kryesore dhe rastet e keqmenaxhimit të fondeve publike, si dhe lëshuar tre (3) reagime ndaj shkeljeve të zbuluara që lidhen me keqmenaxhimin e fondeve publike (për një përmbledhje më të detajuar të aktiviteteve mbi prokurimin publik, shihni titullin 3 më poshtë).


Sa i përket raportimit nga qytetarët përmes platformës Ndreqe.com/Popravi.org, e cila u mundëson qytetarëve të raportojnë mbi cilësinë e shërbimeve komunale, gjithsej 739 raporte janë dorëzuar në vitin 2024. Nga këto, 178 çështje janë adresuar me sukses nga komunat përkatëse.

2.3 Kontributi i D+ në reduktimin e barrës administrative në Kosovë


D+ ka kontribuar në realizimin e disa prej objektivave strategjike të Programit për Parandalimin dhe Zvogëlimin e Barrës Administrative (2022-2027) dhe Planin e Veprimit 2022-2024, duke mbështetur Zyrën për Planifikim Strategjik të Zyrës së Kryeministrit, si koordinatore e këtij procesi.

Kontributi i D+ në mbështetjen e zbatimit të Programit është bërë nëpërmjet disa aktiviteteve si:

- a) Analiza për ofrimin e shërbimeve të orientuara kah përdoruesi në Kosovë;
- b) Takime me përfaqësues të bizneseve;
- c) Video animuese
- d) Debat televiziv me qëllim avokimi dhe informimi rreth procedurave burokratike administrative me të cilat përballen qytetarët dhe bizneset.



Të arriturat kryesore si rezultat i zbatimit të Programit për Parandalimin dhe Zvogëlimin e Barrës Administrative (2022-2027)



2.3.1 Vlerësimi i ofrimit të shërbimeve publike në Kosovë

Për të analizuar shërbimet që ofrohen nga institucionet publike, D+ ka publikuar raportin “Drejt qeverisjes efikase: Vlerësim i shërbimeve publike në Kosovë”. Gjetjet e hulumtimit tregojnë se shërbimet publike në Kosovë përballen me sfida të mëdha në aspektin e digjitalizimit dhe lehtësimit të qasjes për qytetarët. Në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), shërbime të rëndësishme si pensionet dhe certifikatat e sigurisë në punë kërkojnë dorëzim fizik të dokumenteve, duke e vështirësuar procesin për qytetarët, veçanërisht për të moshuarit. Edhe Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) përballlet me vështirësi, pasi aplikimi për licenca kërkon dorëzim manual të dokumenteve, për shkak se formularët ende nuk janë digjitalizuar. Në nivel lokal, Komuna e Graçanicës ilustron problemin më të madh, ku asnjë nga nëntë shërbimet e analizuar nuk ofrohet online, duke detyruar qytetarët të kryejnë vizita personale për çdo aplikim, duke rritur kështu barrën administrative dhe pakënaqësinë.

Që të përmirësohet ofrimi i shërbimeve, D+ ka rekomanduar që të gjitha institucionet duhet t'i japin përparësi digjitalizimit të shërbimeve publike. Formularët dhe dorëzimi i dokumenteve duhet të bëhet përmes internetit, gjë që do të reduktonte nevojën për vizita personale të qytetarëve në insitucione. Gjetjet e këtij raporti janë vizualizuar edhe përmes një videoje të animuar.



2.3.2 Rritja e Ndërgjegjësimit përmes Debatit në TV: Sfida të Bizneseve në Administratën Publike

Debati televiziv “Përballja e Bizneseve me Shtetin”, trajtoi sfidat kryesore që bizneset në Kosovë hasin për shkak të procedurave burokratike administrative. Diskutimi theksoi se si këto procedura po çojnë në rritjen e kostove dhe vonesave të panevojshme, duke krijuar pengesa të mëdha për bizneset. Për më tepër, debati theksoi se si këto pasiguri po nxisin ekonominë informale dhe korrupsionin. Si zgjidhje, pjesëmarrësit theksuan nevojën urgjente për dixhitalizimin e shërbimeve administrative, që do të krijonte një ambient më të favorshëm për bizneset në Kosovë.

2.3.3 Zvogëlimi i barrës administrative: Prioritet për lehtësimin e punës së bizneseve

Në kuadër të përpjekjeve për të përmirësuar mjedisin e të bërit biznes në Kosovë, gjatë vitit 2024 u zhvillua një takim me përfaqësues të bizneseve dhe Odës Ekonomike të Kosovës. Diskutimet u fokusuan në sfidat burokratike dhe nevojën për thjeshtimin e procedurave administrative.

Qëllimi kryesor ishte identifikimi dhe digjitalizimi i shërbimeve administrative që përbëjnë barrë për bizneset, si pjesë e Programit për Parandalimin dhe Zvogëlimin e Barrës Administrative. Takimi rezultoi me një listë rekomandimesh konkrete të cilat i janë dërguar Zyrës për Planifikim Strategjik pranë Zyrës së Kryeministrit dhe institucioneve si Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), Dogana, Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK), Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPM), komunitat dhe ndërmarrjet publike.

2.3.4 Takime me akterë ndër-institucional dhe përfaqësues të shoqërisë civile lidhur me procesin e barrës administrative

Në kuadër të projektit “Promovimi i procedurave të drejta administrative për qytetarë dhe biznese” janë mbajtur dy takime konsultative me akterë institucionalë, përfitues të projektit dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile. Gjatë takimit të parë, është diskutuar për kohëzgjatjen e procesit të thjeshtimit dhe digjitalizimit, sfidat institucionale që lidhen me koordinimin, resurset humane dhe buxhetore, si dhe rolin e shoqërisë civile si mbështetje për të rritur numrin e shërbimeve efikase të orientuara nga interesat e qytetarëve. Ndërsa në takimin e dytë janë prezantuar të gjeturat dhe rekomandimet e analizës së politikave “Drejt qeverisjes efikase: Vlerësim i shërbimeve publike në Kosovë”. Ky raport analizon shërbimet publike në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe vlerëson efikasitetin dhe qasjen e shërbimeve të Ministrisë së Financave, Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM), dhe Komunës së Graçanicës.



2.4 E drejta e qytetarit për kompensim për dëmet e shkaktuara nga autoritetet publike

D+ ka kontribuar në rritjen e vetëdijes publike dhe avokimin për zbatimin e së drejtës së garantuar të qytetarëve për të kërkuar kompensim për dëmet e shkaktuara nga autoritetet publike. Ky kontribut është realizuar përmes aktiviteteve në vijim:

- Monitorimi i dhjetë (10) rasteve në Departamentin për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore, si dhe në Gjykatën e Apelit;
- Përgatitja e raporteve të shkurtra bazuar në monitorimin e dhjetë rasteve të përmendura më sipër;
- Organizimi i takimeve informuese me qytetarët për të drejtën e tyre për të kërkuar kompensim për dëmet e shkaktuara nga autoritetet publike;
- Organizimi i debateve televizive për të angazhuar më tej publikun mbi këtë çështje;
- Ofrimi i ndihmës ligjore falas për qytetarët përmes tre profesionistëve ligjorë të angazhuar nga D+ brenda Agjencisë për Ndihmën Juridike Falas.

2.4.1 Monitorimi i rasteve të shkeljeve administrative ndaj qytetarëve dhe bizneseve

D+ ka monitoruar raste të shkeljeve administrative që kanë të bëjnë me të drejtën për kompensim në procedura administrative në kuadër të marrëdhënieve ndërmjet shtetit (administratës publike) dhe personave fizikë, duke përjashtuar rastet që përfshijnë zyrtarë publikë. Rezultatet e këtij monitorimi janë pasqyruar në pesë raporte:

1. [Kompensimi për personat paraplegjik dhe tetraplegjik nga autoritetet publike](#)
2. [Drejtësia dhe shëndeti: Kompensimi për trajtim mjekësor jashtë institucioneve publike](#)
3. [Dëmet nga autoritetet publike: Rastet e paraplegjikëve dhe tetraplegjikëve në gjykatë](#)
4. [Veprimet ligjore ndaj autoriteteve publike: Ankesat për shërbimet e energjisë dhe ujit në gjykatë.](#)
5. [E drejta për pension të dyfishtë: Përballja e pensionistëve me autoritetet publike në gjykatë](#)

Gjetjet kryesore nga raportet përfshijnë vonesa të gjata gjyqësore në trajtimin e rasteve, mungesën e përfaqësimit ligjor për personat me aftësi të kufizuara dhe boshllëqet ligjore që përjashtojnë hemipleçgjkët, etj. Ndër rekomandimet kyçe të D+ ishin heqja e rivlerësimeve të panevojshme për paraplegjikët dhe tetraplegjikët, si dhe harmonizimi i vendimeve administrative me ligjin. Si rezultat i kësaj, Qeveria ka miratuar një rregullore të re që eliminon praktikën e rivlerësimit dhe përmirëson qasjen në skemat mbështetëse për këtë kategori.

2.4.2 Takime informuese me qytetarë rreth të drejtës për kompensim në rastet e dëmeve të shkaktuara nga autoritetet publike

Me qëllim të ndërgjegjësimin lidhur me këtë të drejtë, D+ ka organizuar pesë takime informuese me qytetarë nga Komuna e Prishtinës, Gjilanit, Ferizajt, Mitrovicës dhe Prizrenit. Përgjatë këtyre takimeve, qytetarët janë informuar për mekanizmat dhe procedurat ligjore lidhur me të drejtën e tyre për kompensim, si dhe për rolin dhe ndihmën juridike që ofron Agjencia për Ndhimë Juridike Falas për këto raste.

Në këtë drejtim vlen të përmendet angazhimi i tre zyrtarëve ligjorë që janë duke ofruar ndihmë juridike falas për qytetarët, në kuadër të një bashkëpunimi mes D+ dhe Agjencisë për Ndhimë Juridike Falas. Zyrtarët ligjorë, do të trajtojnë rastet administrative të qytetarëve që kërkojnë kompensim për dëmet e shkaktuara nga autoritetet publike në Komunën e Prishtinës, Gjakovës dhe Mitrovicës.

Zyrtarët ligjorë, do të trajtojnë rastet administrative të qytetarëve që kërkojnë kompensim për dëmet e shkaktuara nga autoritetet publike në Komunën e Prishtinës, Gjakovës dhe Mitrovicës.

2.4.3 Debate televizive mbi të drejtën për kompensim për dëmet e shkaktuara nga autoritetet publike

D+ ka ngritur vetëdijen publike për të drejtën e qytetarëve për kompensim për dëmet e shkaktuara nga autoritetet publike përmes dy debateve televizive. Këto debate u përqëndruan në kuadrin ligjor për kompensimin e qytetarëve në Kosovë, procesin e paraqitjes së ankesave kundër padrejtësive publike, kohën e pritjes për kompensim nga shteti dhe ndryshimet e pritshme me krijimin e Gjykatës Administrative. Temat kryesore përfshijnë:

- Hapat ligjorë për kërkimin e kompensimit
- Koha e zgjatjes së proceseve gjyqësore dhe periudhat e pritjes për qytetarët për të realizuar të drejtat e tyre
- Ndikimi i vendimeve të paligjshme nga autoritetet publike në ngarkesën e gjykatave
- Roli i Agjencisë për Ndhimë Juridike Falas në mbështetje të qytetarëve



2.5 Përfshirja e qytetarëve në politika publike përmes Aktivitetit Kontrata Sociale

Si partner kryesor lokal në Aktivitetin Kontrata Sociale, me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes qytetare në shpërndarjen e buxhetit lokal, D+ ka organizuar 51 sesione informuese me qytetarë në 13 komuna partnere gjatë vitit 2024. Këto sesione kanë pasur për synim promovimin e buxhetimit me pjesëmarrje dhe informimin e qytetarëve mbi mënyrat se si mund të ndikojnë në mënyrë aktive në ndarjen dhe përdorimin e fondeve publike. Përveç kësaj, D+ ka asistuar në pilotimin e këtij procesi, duke ndihmuar komunat dhe qytetarët në zbatimin e praktikave të buxhetimit me pjesëmarrje.

Ky mekanizëm demokratik, fuqizon qytetarët duke u mundësuar atyre të marrin pjesë në vendimmarrje mbi shpenzimet publike. Përmes këtij procesi, qytetarët jo vetëm që adresojnë nevojat e komunitetit të tyre, por gjithashtu rrisin transparencën dhe llogaridhënien e institucioneve publike.

Sesionet informuese janë organizuar në komunat si në vijim →

Buxhetimi me pjesëmarrje fuqizon qytetarët duke u mundësuar atyre të marrin pjesë në vendimmarrje mbi shpenzimet publike.

Komuna	Nr. i pjesëmarrësve	Nr. i lokaliteteve
Prishtinë	74	6
Prizren	33	4
Gjilan	47	6
Suharekë	56	3
Obiliq	72	7
Ferizaj	11	3
Gjakovë	47	6
Vushtrri	17	2
Viti	8	1
Kamenicë	30	7
Rahovec	9	2
Fushë Kosovë	25	1
Shtime	19	1





Në të njëjtat komuna, duke përfshirë edhe Komunën e Graçanicës, D+ ka monitoruar 190 dëgjime publike dhe ka kontribuar në rritjen e përfshirjes qytetare në proceset vendimmarrëse. Si rezultat i kësaj, gjatë vitit 2024, 1,368 qytetarë kanë marrë pjesë në takimet për buxhetim me pjesëmarrje.

D+ po ashtu ka mbështetur organizimin e 87 takime të grupeve të komunitetit për secilën nga çështjet e planifikuara në Agjendën e Kontratës Sociale. Këto grupe përbëhen nga qytetarë aktivë dhe shërbejnë për zgjidhjen e çështjeve komunitare në bashkëpunim të ngushtë me komunat përkatëse.

Po ashtu u mbajtën 29 takime të tjera me komunitetet në komuna të ndryshme partnere për të diskutuar çështjet e tyre të komunitetit, me pjesëmarrjen e 231 qytetarëve.

Komuna	Nr. i takimeve
Prishtinë	2
Prizren	26
Gjilan	3
Suharekë	6
Obiliq	2
Ferizaj	6
Gjakovë	6
Vushtrri	11
Viti	13
Kamenicë	12



Gjithashtu, në kuadër të këtij aktiviteti janë realizuar me sukses 15 punëtori, me qëllim të mbledhjes së informatave rreth pjesëmarrjes publike në vendimmarrje, nga zyrtarë dhe qytetarë të disa komunave partnere, të ndara si në vijim:

- Pesë punëtori janë organizuar me zyrtarë komunalë të komunave: Fushë Kosovë, Rahovec, Shtime, Graçanicë dhe Kllokot.
- Pesë punëtori janë organizuar me qytetarë të të njëjtave komunave.
- Pesë punëtori përfundimtare janë zhvilluar me pjesëmarrjen e përbashkët të qytetarëve dhe zyrtarëve komunalë.

Në këto punëtori, D+ ka asistuar në identifikimin e grupeve të ndryshme të qytetarëve si dhe lehtësimin e sesioneve dhe diskutimeve të orientuara drejt zgjidhjeve konkrete.

2.5.1 Mbështetje për Këshillat Lokal

Për të promovuar përfshirjen e grave dhe të rinjve në udhëheqjen e Këshillave Lokal, D+ ka organizuar gjashtë sesione informuese, duke synuar integrimin e grupeve të nënpërfaqësuar në hartimin e politikave publike. Këto sesione informuese janë mbajtur në Prishtinë, Prizren dhe Gjilan me pjesëmarrjen e 85 qytetarë.



3. Monitorimi i prokurimit publik

3.1 Monitorimi i prokurimit publik në nivel ministror dhe lokal

Gjatë 2024, D+ ka vazhduar monitorimin e procedurave të prokurimit publik, duke ofruar analizë të thelluar dhe informim të vazhdueshëm për qytetarët lidhur me keqpërdorimin e fondeve publike. Ky monitorim është realizuar përmes analizës së tenderëve të dhënë nga institucionet publike në nivel qendror dhe lokal, me qëllim rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në menaxhimin e parasë publike.

Si rezultat i këtyre aktiviteteve, D+ ka publikuar dy raporte monitorimi, të cilat përfshijnë analizën e njëzet tenderëve të dhënë nga shtatë komuna dhe pesë ministri. Gjetjet e këtyre raporteve kanë evidentuar disa problematika të përsëritura në proceset e prokurimit publik, ndër të cilat përfshihen:

- Përdorimi i procedurës me një burim të vetëm, pa justifikime të mjaftueshme ligjore, që ndikon drejtpërdrejt në kufizimin e konkurrencës mes operatorëve ekonomik;
- Shpërblimi i operatorëve ekonomik që nuk përmbushin kriteret e përcaktuara në dosjet e tenderëve, duke vënë në pikëpyetje integritetin dhe barazinë e procesit të prokurimit;
- Vlerësimet e pasakta të institucioneve, të cilat shpesh rezultojnë në vonesa të zbatimit të kontratave apo në anulime të tenderëve, duke shkaktuar humbje të mundësive për përdorimin efektiv të fondeve publike.

Për të adresuar këto çështje, D+ ka ofruar një sërë rekomandimesh për institucionet publike, të cilat përfshijnë:

- Përdorimin e procedurës së hapur si standard për të garantuar konkurrencën e lirë dhe për të rritur efikasitetin e fondeve publike;
- Ndërprerjen e praktikës së negociatave pa publikim të njoftimit për kontratë, përveç rasteve kur janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 35 të Ligjit për Prokurimin Publik;
- Përmirësimin e proceseve të vlerësimit dhe mbikëqyrjes për të shmangur gabimet që çojnë në vonesa apo anulime të procedurave të prokurimit.



D+ mbetet e përkushtuar në misionin e saj për të promovuar transparencën, konkurrencën dhe llogaridhënien në prokurimin publik, duke ofruar ekspertizë dhe monitorim të vazhdueshëm për të siguruar një menaxhim më të drejtë dhe efikas të burimeve publike.

3.2 Monitorimi i lidhjes së marrëveshjeve për shërbime të veçanta nga institucionet publike të nivelit qendror

Një nga prioritetet kryesore të D+ gjatë vitit 2024 ka qenë monitorimi i kontraktimit të konsulentëve nga institucionet publike përmes marrëveshjeve për shërbime të veçanta. Ky angazhim është vazhdimësi e punës së organizatës në këtë fushë, duke pasur parasysh se D+ ka publikuar raporte të mëparshme monitoruese në vitet 2022 dhe 2023, si dhe ka avokuar në mënyrë të vazhdueshme për parandalimin e keqpërdorimeve në lidhjen e këtyre kontratave.

Gjatë vitit 2024, D+ ka hartuar [raportin e tretë mbi këtë çështje](#), i cili përfshin raste të identifikuara të keqpërdorimeve nga institucionet publike si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal. Bazuar në gjetjet e këtij monitorimi, keqpërdorimet kryesore janë kategorizuar në disa praktika të dëmshme, ku institucionet publike, në kundërshtim me rregullat ligjore, lidhin kontrata për angazhimin e ekspertëve në:

- ▶ Hartimin e politikave dhe strategjive, një praktikë që bie ndesh me parimin e kapaciteteve të brendshme institucionale për zhvillimin e këtyre dokumenteve;
- ▶ Kryerjen e punëve teknike-administrative, duke angazhuar ekspertë në detyra që duhej të përmbusheshin nga personeli i rregullt i institucionit;
- ▶ Shërbimet e teknologjisë së informacionit (IT), në rastet kur institucionet publike nuk justifikojnë mungesën e kapaciteteve të brendshme për të ofruar këto shërbime;
- ▶ Përfaqësimin ligjor në gjykatë, një praktikë që shpesh shmang procedurat e rregullta të prokurimit publik për shërbimet juridike.

D+ do të vazhdojë të monitoroj nga afër këto çështje dhe të angazhohet në avokim për të siguruar një përdorim të drejtë dhe transparent të kontratave për shërbime të veçanta, në përputhje me parimet e llogaridhënies dhe menaxhimit të mirë të burimeve publike.

3.3 Publikimi i artikujve hulamtues

Në kuadër të përpjekjeve për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në prokurimin publik, D+ ka angazhuar gazetarë të specializuar në këtë fushë, të cilët kanë realizuar artikuj hulamtues mbi proceset e prokurimit publik në tri institucione të ndryshme. Këta artikuj kanë trajtuar çështje të rëndësishme që lidhen me shkeljet dhe problematikat në menaxhimin e fondeve publike, duke kontribuar në informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut. Artikujt hulamtues të publikuar gjatë vitit 2024 përfshijnë:

▶ ["Historia 11-vjeçare e objektit që e la pa akreditim Fakultetin e Bujqësisë"](#) – Ky artikull vë në pah pasojat e mungesës së përgjegjësisë institucionale në menaxhimin e projekteve të infrastrukturës arsimore. Fakulteti i Bujqësisë nuk ka shpallur konkurs për pranimin e studentëve të rinj për vitin akademik 2024-2025, pasi objekti i tij ka mbetur një gërmadhë që nga viti 2013, kur nisi ndërtimi. Ky rast thekson nevojën për përgjegjësi institucionale dhe transparencë në menaxhimin e fondeve publike për arsimin e lartë.

▶ ["Dyshimet për kurdisjen e tenderit në Komunën e Prizrenit: A po favorizohet kompania me çmime jo normalisht të ulëta në tenderin 100 mijë euro?"](#) – Ky artikull analizon dyshimet për favorizim të operatorëve ekonomik dhe ofrimin e çmimeve anormalisht të ulëta si mekanizëm për fitimin e kontratave publike. Pas publikimit të artikullit, Komuna e Prizrenit nënshkroi kontratën me çmimin e tregut, duke përjashtuar kompaninë që kishte ofertuar me çmime nën vlerën reale të shërbimit, një praktikë që mund të ndikojë në cilësinë e realizimit të projekteve publike.

▶ ["Tenderi milionësh për mensën e AKSP-së: Pse ndërtimi nuk përfundoi brenda afateve?"](#) – Ky hulamtim trajtoi vonesat e pajustificueshme në ndërtimin e objektit të mensës në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (AKSP). Artikulli theksoi nevojën për monitorim më të rreptë të zbatimit të kontratave dhe llogaridhënie për vonesat, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në ofrimin e shërbimeve publike dhe përdorimin e duhur të buxhetit shtetëror.

Përmes këtyre artikujve, D+ ka kontribuar në rritjen e transparencës dhe adresimin e problematikave në prokurim publik, duke nxitur përgjegjësi më të madhe institucionale dhe ndërgjegjësim qytetar mbi menaxhimin e fondeve publike.

3.4 Analizimi i procedurave në prokurim publik

Në kuadër të angazhimit për forcimin e integritetit dhe transparencës në prokurimin publik në Kosovë, D+ ka hartuar dhe publikuar analiza të shkurtra, të cilat trajtojnë sfidat kyçe të prokurimit publik në nivel politik dhe praktik. Këto analiza shpërfaqin raste konkrete që ilustrjnë praktika të korrupsionit, keqpërdorimit, mosndëshkueshmërisë dhe problemeve gjinore, duke ofruar rekomandime të qarta për përmirësimin e politikave dhe forcimin e mekanizmave mbikëqyrës.

"Rënia e kulmit të objektit të Komunës së Prishtinës – alarm për luftimin e korrupsionit në prokurimin publik"

Ky raport thekson mungesën e një kulture ndëshkuese ndaj kompanive që falsifikojnë, keqpërdorin apo mashtrojnë në proceset e prokurimit publik. Si shembull konkret, analiza sjell rastin e kompanisë NBT-ING Sh.P.K., e cila fitoi kontratën për rikonstruktimin e kulmit të objektit të Komunës së Prishtinës, pavarësisht se pronari i saj kishte dy dënime gjyqësore të mëparshme. Kjo situatë ishte e mundur për shkak të mangësive në zbatimin e ndalimeve për pjesëmarrje në prokurim publik ndaj personave juridik të dënuar për vepra penale.

Ky raport mori vëmendje të gjerë mediatike dhe nxiti reagime të menjëhershme institucionale. Pas një hetimi të nisur nga organet kompetente, përfaqësues të kompanisë dhe zyrtarë të Komunës së Prishtinës u dënuan nga gjykata për përgjegjësinë e tyre në këtë incident, duke e kthyer këtë rast në një precedent të rëndësishëm për forcimin e masave kundër korrupsionit në prokurim publik.

"Realiteti 2% – hendeku i madh gjinor në lidhjen e kontratave publike"

Ky raport analizon nivelin e ulët të përfshirjes së bizneseve në pronësi të grave në kontratat publike gjatë vitit 2023. Analiza tregon se, pavarësisht se një numër i konsiderueshëm i bizneseve janë në pronësi të grave, pjesëmarrja e tyre në prokurimin publik mbetet shumë e ulët, duke arritur vetëm 2% të vlerës totale të kontratave publike.

Raporti identifikon faktorët kryesorë që pengojnë barazinë gjinore në këtë sektor dhe ofron rekomandime konkrete për adresimin e këtyre sfidave, përfshirë masa të posaçme për fuqizimin e grave në prokurim publik dhe krijimin e mekanizmave që sigurojnë qasje të barabartë në kontratat publike.

"Ligji për Përgjegjësinë e Personave Juridik për Vepra Penale – potencial i pashfrytëzuar në luftimin e korrupsionit në prokurimin publik"

Kjo analizë fokusohet në mungesën e zbatimit të Ligjit për Përgjegjësinë Penale të Personave Juridik dhe ndikimin e kësaj praktike në përhapjen e korrupsionit në prokurimin publik. Përmes tre rasteve konkrete, raporti ilustron se si kompanitë e përfshira në falsifikime dhe mashtrime në tenderë publik kanë përfituar miliona euro, ndërsa sanksionet e shqiptuara ndaj tyre kanë qenë minimale – shpesh më pak se 2% e vlerës totale të përfituar.

Kjo analizë është ndër të parat që trajton rëndësinë e zbatimit të këtij ligji dhe nevojën për forcimin e mekanizmave ndëshkues ndaj kompanive që keqpërdorin fondet publike. D+ ka vazhduar avokimin për përmirësimin e legjislacionit dhe rritjen e efikasitetit të sistemit të drejtësisë në trajtimin e rasteve të korrupsionit në prokurim publik.



Prokurimi publik, konkretisht kontratat publike, paraqesin një nga mekanizmat më të rëndësishëm për shpërndarjen e parasë publike, përmasa të cilit institucionet kontraktuese punë, mallra dhe shërbime.

Kontratat publike janë themel të rëndësishme për një numër të madh të bizneseve, pasi që ato sigurojnë një rrjetë të gjerë investimesh dhe të shërbimeve të ardhurave, duke u garantuar bizneseve një stabilitet financiar. Në Kosovë, gjatë vitit 2023, institucionet publike lidhën 10,183 kontrata, me vlerë totale prej 892.538.403,00€, që paraqet 8.23% të Bruto Produktit Vendor (BPV).

Nëse krahasojmë ndarjen e këtyre kontratave se sa prej ligje fitohen nga bizneset që janë në pronësi të burrave e sa në pronësi të grave, atëherë del se shpërndarja e tyre është shumë jo proporcionale. Sipas të dhënave nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK), në vitin 2023 në Kosovë latin 96,995 biznese aktive, ku 76,236 (78.7%) latin në pronësi të burrave, 17,697 (18%) në pronësi të grave, 231 (0.2%) në bashkëpronësi të të paktën një gruaje, ndërkohë që 970 (1%) tjera nuk dihet gjinia e pronarit. Përveç faktit që bizneset në pronësi të grave

3.5 Identifikimi i sfidave në zbatimin e Ligjit për Prokurimin Publik

Në kuadër të përpjekjeve për të identifikuar dhe adresuar sfidat në zbatimin e Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), D+ ka organizuar një seri takimesh dhe diskutimesh me akterët kryesorë të përfshirë në këtë proces.

Në këtë drejtim, D+ ka realizuar disa takime me përfaqësues të komunitetit të biznesit në shtatë komunat më të mëdha në Kosovë, ku morën pjesë mbi 60 përfaqësues të bizneseve. Takimet u fokusuan në diskutimin e sfidave praktike me të cilat përballen operatorët ekonomik gjatë procedurave të prokurimit publik, mbledhjen e rekomandimeve për rritjen e efikasitetit të këtyre procedurave dhe ndarjen e praktikave të mira nga procesi i tenderimit.

Po ashtu, D+ ka organizuar një punëtori me zyrtarë të prokurimit publik nga rreth 20 komuna të Kosovës, me qëllim të mbledhjes së komenteve dhe rekomandimeve të tyre mbi zbatimin e Ligjit për Prokurimin Publik, si dhe identifikimin e mundësive për përmirësimin e projektligjin e ri.

3.6 Monitorimi i punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit (OShP)

Gjatë vitit 2024, D+ ka vazhduar monitorimin e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OShP), me fokus në vlerësimin e paanshmërisë dhe efikasitetit të këtij mekanizmi në trajtimin e ankesave. Analiza e vendimeve dhe praktikave të OShP-së për periudhën janar-qershor 2024 është përmbledhur në [raportin "Organi Shqyrtues i Prokurimit: Monitorim dhe Rekomandime \(Janar – Qershor 2024\)"](#), i cili shqyrton sfidat, progresin dhe mundësitë për përmirësimin e funksionimit të këtij organi.

Një nga rekomandimet kryesore të dala nga ky raport, i cili është marrë parasysh nga OShP-ja, ka qenë shmangia e kategorizimit të rasteve si "pjesërisht të bazuara" në ekspertizat e ekspertëve shqyrtues. Kjo praktikë është identifikuar si një faktor që vështirëson procesin e vendimmarrjes për panelin shqyrtues. Si rezultat i këtij rekomandimi, në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2023, është vërejtur një ulje e ndjeshme e rasteve ku ekspertizat e ekspertëve shqyrtues e kategorizojnë një ankesë si "pjesërisht e bazuar".

Një tjetër rekomandim i rëndësishëm ka qenë prioritizimi i rekrutimit të ekspertëve të brendshëm dhe reduktimi i përdorimit të ekspertëve të jashtëm, me qëllim sigurimin e stabilitetit dhe paanshmërisë në procesin shqyrtues. Aktualisht, ky rekomandim është duke u zbatuar, dhe procesi i përzgjedhjes dhe emërimit të ekspertëve të brendshëm është në fazën e vlerësimit të aplikantëve.

Përveç monitorimit dhe ofrimit të rekomandimeve, D+ ka mbështetur OShP-në në hartimin e planit të performancës për vitin 2025. Nëpërmjet angazhimit në grupin punues të këtij organi, është arritur që të hartohet një plan performance gjithëpërfshirës, i cili përmban objektiva strategjike, indikatorë dhe aktivitete të matshme, me synimin për të rritur më tej efikasitetin dhe transparencën e OShP-së.

3.7 Reagimet publike mbi keqpërdorimin e procedurave të prokurimit publik

D+ ka avokuar për anulimin e procedurave të prokurimit publik që kanë shfaqur elemente të keqpërdorimit dhe shkeljes së ligjit. Përmes reagimeve publike dhe presionit institucional, D+ ka ndihmuar në parandalimin e shpërdorimeve financiare dhe forcimin e integritetit në prokurimin publik.

Kërkesë për anulimin e kontratës për shërbimin e Arkitektit të Kryeqytetit

Në vitin 2024, Komuna e Prishtinës ka shkelur Ligjin e Prokurimit Publik në kontratën 12 milionëshe për "Shërbimi i Arkitektit të Kryeqytetit", duke emëruar një anëtar të paligjshëm në komisionin e vlerësimit të ofertave. D+, përmes një raporti të detajuar, i bëri thirrje komunës që të anulojë kontratën dhe kërkoi nga Prokuroria Speciale e Kosovës të nisë hetime mbi këtë aktivitet të prokurimit. Gjetjet u publikuan përmes një konference për media.

Anulimi i kontratës për shërbime konsulente nga Komuna e Vushtrrisë

Në mars 2024, Komuna e Vushtrrisë shpalli një tender për kontraktimin e 40 konsulentëve, me vlerë të parashikuar 591,841.60 euro, në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik dhe Rregulloren nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Këta konsulentë do të angazhoheshin për pozita të zakonshme administrative, të cilat duhet të plotësohen përmes procedurave të rregullta të rekrutimit. Si rezultat i reagimit publik dhe presionit nga D+, Komuna e Vushtrrisë e anuloi këtë tender, duke parandaluar keqpërdorimin e mbi 591 mijë eurove nga buxheti i shtetit.

Thirrje për ndalimin e keqpërdorimit të marrëveshjeve për shërbime të veçanta

Nga viti 2021 deri në 2024, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka zhvilluar pesë aktivitete të prokurimit për shërbime konsulente, ku në katër raste të ndara është shpërblyer i njëjti konsulent. Në tre nga këto raste, shërbimet e prokuruar përkonin me përgjegjësitë e Departamentit të Tatimit në Pronë, që do të duhej të kryheshin nga stafi i rregullt i punësuar përmes procedurave standarde të rekrutimit. D+ i ka bërë thirrje kësaj ministrie që të ndalojë përdorimin e marrëveshjeve për shërbime të veçanta (MShV) si mënyrë për të vazhduar punësimet në pozita të cilat duhet të rekrutohen përmes konkurseve të hapura dhe transparente.

3.8 Takime avokuese për përmirësimin e procedurave të prokurimit publik

D+ ka zhvilluar takime avokuese me përfaqësues të ministrive, komunave, deputetë të Kuvendit të Kosovës, organizata të shoqërisë civile dhe akterë të tjerë. Këto takime kishin për qëllim diskutimin dhe adresimin e gjetjeve nga raportet e D+ mbi prokurimin publik, si dhe propozimin e rekomandimeve për përmirësime në nivel politikash.

Në këtë kuadër, janë mbajtur takime të drejtpërdrejta me institucione kyçe, si:

- Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
- Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP)
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit
- Autoriteti i Konkurrencës

Diskutimet kanë përfshirë:

- Punën e D+ në monitorimin e prokurimit publik
- Gjetjet mbi shkeljet në tenderë dhe marrëveshjet për shërbime të veçanta
- Luftën kundër korrupsionit në prokurim publik
- Rekomandimet për përmirësimin e procedurave dhe kuadrit ligjor

3.9 Pjesëmarrja në plotësim-ndryshimin e Rregullores për Prokurim Publik

Gjatë vitit 2024, D+ ka kontribuar në procesin e plotësimit dhe ndryshimit të rregullores së Prokurimit Publik, i cili është një dokument i rëndësishëm sekondar ligjor që derivon nga Ligji për Prokurim Publik. Në kuadër të punëtorive të organizuara për draftimin e kësaj rregulloreje, D+ ka zhvilluar një sërë diskutimesh dhe ka paraqitur rekomandime të cilat janë pranuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik dhe janë adoptuar në versionin përfundimtar të rregullores.

Këto rekomandime kanë pasur një ndikim të drejtpërdrejtë në harmonizimin e rregullores me ligjin dhe adresimin e shqetësimeve të ngritura nga bizneset dhe akterët e tjerë të përfshirë në procesin e prokurimit publik. Disa nga rekomandimet e pranuar përfshijnë: ndryshimin e klasifikimit të informacionit afarist, një kërkesë e shfaqur në takimet që D+ ka organizuar gjatë vitit në shtatë komunitat më të mëdha të Kosovës; largimin e kërkesës për noterizim të dokumentacionit ofertues, e cila krijonte një barrë administrative dhe financiare për bizneset; heqjen e kërkesës që në rast konzorciumi, të gjithë operatorët ekonomik të jenë të pajisur me çertifikatat e kërkuara në vend; si dhe sqarimin e kontraktimit të ekspertëve të jashtëm në komisionet e vlerësimit të tenderëve, një temë që D+ e ka trajtuar gjatë vitit.





3.10 Monitorimi i projekteve publike me Auditimin Social

Gjatë vitit 2024, D+ ka zbatuar me sukses projektin e Auditimit Social, duke fuqizuar qytetarët për të monitoruar dhe vlerësuar mënyrën se si shpenzohen fondet publike në nivel lokal. Ky proces ka synuar rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe përmirësimin e shërbimeve publike në disa komuna të Kosovës.

D+ ka angazhuar grupe qytetarësh në Lipjan dhe Obiliq, të cilët kanë monitoruar projekte të rëndësishme komunale, si ndërtimi i sallës së sporteve në shkollën "Ismail Luma", ndërtimi i çerdhes në Rufe të Ri, parkut në Bakshi dhe parkingut publik në Obiliq. Gjatë këtij procesi, qytetarët kanë marrë pjesë aktive në trajnime, takime me institucione dhe vizita në terren, duke analizuar progresin dhe cilësinë e këtyre investimeve.

Raportet e përgatitura nga grupet e Auditimit Social kanë ofruar gjetje konkrete dhe rekomandime praktike, të cilat synojnë përmirësimin e menaxhimit të fondeve publike dhe adresimin e problemeve të evidentuara.

Qytetarët jo vetëm që kanë monitoruar investimet publike, por edhe kanë ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e qeverisjes lokale dhe forcimin e llogaridhënies institucionale. Këto raporte janë dorëzuar në takime me kryetarët e komunave, ku qytetarët kanë marrë zotime me shkrim dhe afate kohore konkrete për adresimin e rekomandimeve të tyre.

Auditimi Social ka dëshmuar se qytetarët, kur janë të informuar dhe të përfshirë, mund të jenë një forcë kyçe për ndryshime pozitive në komunitetin e tyre. Përkushtimi i D+ për të avancuar transparencën dhe qeverisjen e mirë do të vazhdojë, duke ndihmuar në krijimin e një administrate më të hapur dhe të përgjegjshme ndaj qytetarëve.



4. Përpyjekjet për parandalimin e përhapjes së lajmeve të rreme

4.1 Lansimi i Indeksit të Cenueshmërisë ndaj Dezinformimit në Kosovë

Në kuadër të DISICON, është lansuar edicioni i dytë i Indeksit të Cenueshmërisë ndaj Dezinformimit në Kosovë. Ky Indeks ofron një vlerësim në shkallë të matshme të cenueshmërisë së Kosovës ndaj dezinformimit, duke vlerësuar situatën aktuale dhe duke identifikuar faktorët kryesorë kontribues. Qëllimi i këtij Indeksi është të shërbejë si mjet politikash për vendimmarrësit, por edhe si burim informacioni për të kuptuar dinamikën brenda mjedisit mediatik të Kosovës si dhe qëndrimet e qytetarëve ndaj dezinformimit. Gjetjet kryesore konstatojnë se Kosova shënon 57 pikë nga 100 (shkalla më e lartë) në shkallën e cenueshmërisë.

Të gjeturat e këtij raporti janë prezantuar edhe në Forumin Botëror për Demokraci, organizuar nga Këshilli i Evropës.



Ky Indeks ofron një vlerësim në shkallë të matshme të cenueshmërisë së Kosovës ndaj dezinformimit, duke vlerësuar situatën aktuale dhe duke identifikuar faktorët kryesorë kontribues.

4.2 Trajnime informuese me të rinjë për identifikimin e lajmeve të rreme

D+ në bashkëpunim me BIRN Kosova ka mbajtur sesione informuese me rreth 230 të rinjë nga 15 komuna të Kosovës, përfshirë edhe komuna me shumicë serbe.

Këto sesione synuan të rrisin ndërgjegjësimin dhe të aftësojnë të rinjtë në identifikimin e lajmeve të rreme, duke u fokusuar te mënyrat më efektive për t'i trajtuar ato dhe procedurat e duhura për raportim të këtyre lajmeve. Përmes këtyre aktiviteteve, pjesëmarrësit fituan njohuri të vlefshme për të kuptuar dhe kundërshtuar dezinformimin në komunitetin e tyre.





4.3 Kampi veror i dezinformimit

D+ ka organizuar kampin veror me mbi 20 të rinjë nga komuna të ndryshme të Kosovës për t'i trajnuar ata se si të mbrohen nga lajmet e rreme. Nga leximi i sigurtë në internet, deri te identifikimi i mjeteve dezinformuese dhe trajtimi i informacioneve të krijuara nga inteligjenca artificiale – këto ishin vetëm disa nga temat që janë trajtuar në këtë kamp.

Ky është viti i dytë që D+ dhe Konrad-Adenauer-Stiftung Kosovo organizojnë këtë kamp me qëllim të avancimit të njohurive të rinisë kosovare për mbrojtje nga dezinformimi.



5. Raportimet dhe ndreqjet në platformën ndreqe.com

Në platformën ndreqe.com, gjatë vitit 2024 qytetarët kanë raportuar 750 ankesa, prej të cilave 180 janë trajtuar nga organet komunale. Raportimet e qytetarëve kanë qenë në të gjitha kategoritë: Ndrëçim publik, Ujëra të zeza, Mbeturina, Ambient, Trotuar i dëmtuar, Gropë në rrugë, dhe të tjera.

Platforma ndreqe.com ka vazhduar të zhvillojë një bashkëpunim të suksesshëm me disa komuna, duke përfshirë Komunën e Istogut dhe atë të Mitrovicës së Jugut. Gjatë vitit 2024, janë realizuar dy storie suksesi në këto komuna, ku zyrtarët lokalë kanë reaguar pozitivisht ndaj raportimeve të qytetarëve për heqjen e mbeturinave, edhe në zona të vështira dhe me rrezik. Pas ndërhyrjeve, zyrtarët kanë njoftuar ekipin e platformës duke dërguar fotografi nga terreni, dhe duke treguar angazhimin për zgjidhjen e problemeve të raportuara.

Aktivitete të tjera

Angazhimi i 30 praktikantëve në komisione parlamentare në Kuvendin e Kosovës, institucione lokale dhe organizata joqeveritare

Gjatë vitit 2024, D+ ka vazhduar të mbështesë komisionet parlamentare në përmbushjen e detyrave të tyre përmes angazhimit të 15 praktikantëve në komisione të ndryshme të Kuvendit të Kosovës. Praktikantët kanë luajtur një rol të rëndësishëm në asistimin e stafit të komisioneve, duke kontribuar në organizimin e mbledhjeve dhe kryerjen e hulumtimeve për temat që janë trajtuar në komisione. Ky program shënoi vitin e shtatë të suksesshëm të angazhimit të praktikantëve nga D+ në Kuvendin e Republikës së Kosovës, duke dëshmuar përkushtimin tonë për fuqizimin e të rinjve dhe përmirësimin e proceseve parlamentare.



Për të forcuar më tej angazhimin ndaj të rinjve, D+ ka zgjeruar programin e praktikës edhe në nivel lokal. Në kuadër të projektit “Programi i 8-të i Punës Praktike në Nivelin Lokal”, i financuar nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE), 15 të rinjë nga komunitete të ndryshme të Kosovës janë përzgjedhur për të mbajtur punën praktike për pesë muaj në institucione dhe organizata në nivelin lokal.

D+ po ashtu ka organizuar diskutime mes deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe të rinjve. Temat e diskutimit ishin të fokusuar kryesisht në angazhimin e rinisë në politikë, ndikimin e komisioneve parlamentare në përmirësimin e politikave publike, reformat në drejtësi, mandatin e lirë të deputetëve, e shumë pyetje të tjera të parashtruara nga pjesëmarrësit.

Monitorimi i zotimeve zgjedhore nga Kryetarët e Komunave

D+ dhe partnerët e saj përgjatë vitit 2024 kanë monitoruar përmbushjen e zotimeve të bëra nga nëntë kryetarë të komunave, gjatë fushatës zgjedhore. Në vitin e fundit të mandatit, rezultatet e monitorimit tregojnë se 74 zotime janë përmbushur plotësisht, 95 zotime janë në proces zbatimi dhe 32 zotime nuk kanë shënuar asnjë progres, siç është dokumentuar në [raportin final](#).


Më shumë detaje rreth zotimeve, gjenden në platformën tonë interaktive: <https://zotimet.forumi.online/sq>.

Paraqitjet mediale

Për të informuar publikun mbi punën e institucioneve publike dhe aktivitetet e D+, stafi i organizatës ka pasur mbi 70 paraqitje mediale, përfshirë intervista dhe shkrime për media. Gjatë këtyre paraqitjeve, D+ ka reaguar për çështje të ndryshme të politikave publike duke dhënë opinione dhe rekomandime, promovim të punës së projekteve, platformave etj. Vlen të përmendet edhe organizimi i dy debateve televizive me qëllim diskutimin rreth të drejtës së qytetarëve për kompensim në rast të dëmit të shkaktuar nga autoritetet publike.

Pjesëmarrja në forume dhe ngjarje për demokraci dhe qeverisje të mirë

Gjatë vitit 2024, përfaqësuesit nga D+ kanë marrë pjesë aktive në një numër panelesh dhe forumesh të rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare, duke kontribuar në promovimin e demokracisë dhe qeverisjes së mirë. Këtu përfshihen pjesëmarrja në Forumin Parlamentar për Qytetarët në Tiranë, Javën për Qeverisje të Hapur, Ditën Ndërkombëtare të Demokracisë të mbajtur në Kuvendin e Kosovës, përfaqësimin në Forumin Botëror për Demokraci, si dhe aktivitete të tjera në kuadër të mbrojtjes së demokracisë. Përmes këtyre angazhimeve, D+ ka kontribuar në adresimin e çështjeve kyçe për forcimin e transparencës, pjesëmarrjes qytetare dhe dialogut demokratik.



Supporting municipal public participation practice



D+ pjesë e Samitit mbi praktikat më të mira të pjesëmarrjes publike

Samiti synoi të shpërndajë njohuri në të gjitha komunitetet e Kosovës mbi metodat efektive të angazhimit publik, duke përfshirë buxhetimin me pjesëmarrje, shpërblimet jofinanciare dhe dëgjimet publike gjithëpërfshirëse.

Gjatë këtij organizimi, Drejtori Ekzekutiv i D+, Valmir Ismaili, mori pjesë në një panel diskutimi mbi temën “Monitorimi i Komunave në Mekanizmat e Pjesëmarrjes Publike,” ku ai theksoi misionin e D+: “D+ fokusohet në fuqizimin e komuniteteve për të marrë pjesë në vendimmarrje, për të formësuar politikat publike, për të adresuar çështjet komunitare dhe për të përmirësuar shërbimet publike. Partneriteti ynë me Aktivitetin e Kontratës Sociale pasqyron përkushtimin tonë të vazhdueshëm ndaj këtij misioni.”

Ai gjithashtu theksoi rolin e D+ në ndërtimin e besimit të komunitetit në komunitet partner, duke promovuar histori suksesi dhe duke zgjeruar rrjetet e qytetarëve dhe influencuesve të angazhuar. Përmes bashkëpunimit konstruktiv me komunitet, D+ nxit komunikimin transparent dhe edukon komunitetet mbi përdorimin efektiv të mekanizmave të pjesëmarrjes publike.

Samiti u organizua nga Aktiviteti i Kontratës Sociale i USAID-it.

D+ në “Kosova PAR 2024”

Në panelin e organizuar nga D+ në kuadër të konferencës Kosova PAR në vitin 2024, u zhvilluan diskutime të rëndësishme mbi përmirësimin e integritit të perspektivës gjinore në dizajnimin dhe zbatimin e platformave dhe shërbimeve digjitale.

Pikat kryesore të diskutimit përfshinë:

- Politika publike lidhur me digjitalizimin mbeten neutrale ndaj gjinisë, duke dështuar të përmbushin nevojat e ndryshme të grave dhe burrave.
- Të dhënat e ndara sipas gjinisë dhe buxheti gjinor janë thelbësore për të kuptuar dhe adresuar boshllëqet në shërbimet digjitale për grupet e marginalizuara.
- Roli dhe mbështetja e organizatave ndërkombëtare dhe shoqërisë civile mbetet thelbësore në rritjen e kapaciteteve të institucioneve për të integruar aspektin gjinor në reformën e digjitalizimit në Kosovë.



D+ pjesë e Javës për Qeverisje të Hapur

D+ mori pjesë në takimin e organizuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, në kuadër të Javës për Qeverisje të Hapur të Partneritetit për Qeverisje të Hapur (OGP).

Gjatë këtij takimi, u theksua se bashkëpunimi ndërmjet Kuvendit dhe organizatave të shoqërisë civile ka qenë shumë konstruktiv, duke u mundësuar kështu organizatave për të dhënë kontributin e tyre në procesin e vendimmarrjes dhe rritjes së transparencës parlamentare. Albert Krasniqi nga D+, gjithashtu përmendi disa nga arritjet, por edhe ngecjet që sipas tij Kuvendi ka shënuar në disa segmente.



D+ pjesë e Forumit “Parlamenti për Qytetarët” në Tiranë

D+ mori pjesë në Forumin “Parlamenti për Qytetarët” në Tiranë organizuar nga IDM Albania me mbështetjen e qeverisë britanike.

Në këtë Forum, përfaqësuesi i D+, Emir Abrashi, solli përvojën e organizatës sonë në bashkëpunimin me Kuvendin e Kosovës për nismat legjislative, plotësimin dhe monitorimin e zbatimit të ligjeve.



Finalizimi i kornizës ligjore për punësimin sezonal në Kosovë

Grupi punues i përbërë nga përfaqësues të Ministrisë së Financave, Administratës Tatimore të Kosovës, Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës, gjatë vitit 2024 ka punuar në finalizimin e materialeve përcjellëse për rregullimin e kornizës ligjore për punësimin sezonal.

Anëtarët e grupit kanë kontribuar me ekspertizën e tyre, ndërsa D+ si mbështetës dhe implementues i projektit lehtësoi diskutimet dhe siguroi burimet e nevojshme për finalizimin e këtij procesi.



Anëtarët e grupit kanë kontribuar me ekspertizën e tyre, ndërsa D+ si mbështetës dhe implementues i projektit lehtësoi diskutimet dhe siguroi burimet e nevojshme për finalizimin e këtij procesi.



Fuqizimi i organizatave me bazë në komunitet

Në kuadër të projektit “Mbështetja e BE-së për Ndërtimin e Besimit në Ballkanin Perëndimor”, i implementuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) dhe i zbatuar nga D+, gjatë hartimit të raportit për hartëzim të organizatave me bazë në komunitet të cilat merren me ballafaqimin me të kaluarën, D+ ka identifikuar 51 organizata. Prej tyre, përfaqësues të 11 organizatave janë përzgjedhur për të marrë pjesë në sesionin e parë dhe të dytë për ngritje të kapaciteteve (avokim publik dhe organizim fushatash), me në total 20 pjesëmarrës. Në sesionin e tretë dhe të katërt (ngritje fondesh dhe komunikim), përfaqësues të nëntë organizatave kanë marrë pjesë, me në total 17 pjesëmarrës. Ndërkaq, në sesionin e fundit (planifikim dhe implementim i projekteve), përfaqësues të tetë organizatave kanë marrë pjesë, me në total 15 pjesëmarrës.

Në fazën e mentorimit, janë mentoruar tetë organizatat të cilat kanë marrë pjesë në të gjitha pesë sesionet për ngritje të kapaciteteve.

Në fazën e mentorimit, janë mentoruar tetë organizatat të cilat kanë marrë pjesë në të gjitha pesë sesionet për ngritje të kapaciteteve.

6. Partnerët dhe donatorët

Aktivitetet dhe rezultatet e mësipërme nuk do të ishin të mundura pa mbështetjen, përkrahjen dhe partneritetin e organizatave të ndryshme vendore e ndërkombëtare.

Të gjitha raportet e auditimit të organizatës, janë të publikuara në faqen tonë: <https://dplus.org/per-ne/>

